



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE	
No. i regjistruar	01
No. i regjistruar	139
No. i regjistruar	02
Data	18.09.2012
PRISHTINEJA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. prot. 22/2012
Datë: 18.09.2012

Në mbështetje të nenit 3, nenit 29 (paragrafi 1,2, nënparagrafi 2.1,2.3), nenit 35 (paragrafi 1), nenit 47, nenit 69 i Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikqyrësi Shtetëror nxjerr:

V E N D I M

1. Këshillohet Autoriteti i Aviacionit Civil që në regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat të bëjë konform nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-172, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Obligohet Autoriteti i Aviacionit Civil që në afatë prej 15 ditësh të njoftoj Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Gjatë kontrollit që është bërë në Autoritetin e Aviacionit Civil kemi konstatuar që regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesa nuk përmbushin rregullativën ligjore. Sipas nenit 69 të Ligjit Nr.03/L-172 parasheh që organet e sektorit publik dhe privat për arsye të mbrojtjes së sigurisë së njerëzve dhe sigurimit të pronës mund të kërkojnë nga personat që hyjnë ose dalin nga ndërtesat tu japin të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni. Nëse konsiderohet e domosdoshme të dhënat personale mund të verifikohen duke i ekzaminuar dokumentet e identifikimit.

Të dhënat nga paragrafi 2 i këtij neni konsiderohen si dokumente zyrtare, nëse grumbullimi i të dhënave kërkohet për qëllime të policisë dhe aktiviteteve të shërbimeve të inteligjencës.

Të dhënat e regjistrimit të personave që hyjnë ose dalin nga ndërtesat mund të përmbajnë vetëm këto të dhëna personale: emrin (at) personal, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë.

Të dhënat personale nga regjistrimet mund të ruhen deri në tri (3) vjet nga dita e regjistrimit të tyre dhe pastaj duhet të fshihen ose shkatërrohen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ramadan Qehaja

Mbikëqyrës Shtetëror

Vendimi i dërgohet:

- Autoriteti i Aviacionit Civil
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

